

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ndahet nga jeta Esat Bushati, legjenda e Vllaznisë/ Beci: Futbolli shkodran humbi sot një nga emrat e tij të respektuar
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sport/ndahet-nga-jeta-esat-bushati-legjenda-e-vllaznise-beci-futbolli-shkodran-h-i586725
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 14:58:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 14:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	05bcadde9aeaa6a5a71d9ac084cf6b9f72e6daa26589ccef6818bb3e3882793c
TEKSTI	9224123e1f2080065e00585db6a1446d9a583db0e79a672a3cef0870f4eb09d6
PAMJA	e217bff8d37157b75ca03c7276b64134396af416d32e9a00e90d28b8648bf0f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a4873ce824bbb4a989c8ce0406e96356528d999d5f073a9b86bfa752950b4266
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dc0b234c87b6bef6f484ef22e44d5789ea8bfa692c7eb14dae36a548c590e2a2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a4873ce824bbb4a989c8ce0406e96356528d999d5f073a9b86bfa752950b4266>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1e [Ndahet nga jeta Esat Bushati, legjenda e Vllaznisë/ Beci: Futbolli shkodran humbi sot një nga emrat e tij të respektuar](#) [Jordania dhe Franca nënshkruajne marrëveshje b](#)
fundit

Ndahet nga jeta Esat Bushati, legjenda e Vllaznisë/ Beci: Futbolli shkodran humbi sot një nga emrat e tij të respektuar



17 Shtator 2026, 16:55Sport TEMA



Pasditen e sotme futbolli shkodran ka humbur një nga emblemat e tij. Bëhet fjalë për ish- futbollistin e Vllaznisë, Partizanit dhe kombëtares shqiptare Esat Bushati i cili ka ndërruar jetë në moshën 97 vjeçare. Me këtë rast në emër të redaksisë së Gazeta “Shkodra Sport” dhe gjithë lexuesve të saj i shprehim ngushëllimet familjes për humbjen e njeriut të saj të dashur!

Esati Ka lindur në Shkodër më 3.5.1929. Të 17 vitet e karrierës së tij natyrisht që kanë lënë gjurmë tek të gjithë. Esat Bushati, mbrojtësi i njohur i Vllaznisë së viteve '50, ka dhënë jo pak për futbollin. Këtë lojë shumë të dashur për të, ai e nis që herët. E ndihmojnë për t'u marrë me futboll karakteristikat e tij fizike, shkruan www.shkodrasport.com

Esati do të fillonte të luante me ekipin e parë të Vllaznisë në vitin 1947, menjëherë pasi ajo kishte fituar dy tituj rradhazi në vitet 1945 dhe 1946. Edhe këtë vit kur ai debuton me fanellën kuqeblu, skuadra shkodrane do ishte pretendente për titullin kampion deri në ndeshjen e fundit. Bushati do të luante në repartin e mbrojtjes përkrah një emri të madh si Muhamet Dibra duke qenë një lojtar bazë deri në vitin 1949 kur thirret në ekipin e Partizanit.

Sigurisht që përvoja e marrë duke luajtur përkrah Dibrës, Gjeloshit, Osmanit, Gjonit e Cufjes, do ta ndihmonin shumë atë tek skuadra e kuqe. Prandaj ai nuk e pati të vështirë të luante përkrah Spahut e Fagut e lojtarë të tjerë që ishin njëkohësisht përveçse më të mirët e Partizanit, edhe bërthama e përfaqësueses sonë, shkruan Gazeta “Shkodra Sport”.

Në këtë mënyrë, profili i tij si sportist cilësor plotësohet gjithnjë e më shumë. I uan përveç Vllaznisë dhe Partizanit edhe me Sportklub Tiranën si nërfornim në

Me këtë mënyrë, përmirësimi i shprehjes shpreh përcaktimet gjatë e me emrat Esat për të Vllaznisë dhe Partizanit dhe me shprehjet historike për të ndeshjet miqësore ndërkombëtare. Po ashtu, do ishte edhe pjesë e kombëtares sonë në ndeshjet miqësore që ajo zhvilloi këtë periudhë me Spartakun e Moskës, Levskin e Sofjes etj. Me Partizanin ka luajtur deri në vitin 1954 duke u aktivizuar si mbrojtës i djathtë.

Një nga karakteristikat kryesore që ka shoqëruar Esat Bushatin në karrierën e tij ka qenë edhe qëndrimi shumë korrekt dhe i disiplinuar si në fushë ashtu edhe jashtë saj. Po ashtu, ai fitoi edhe respektin e futbollistëve më të mëdhenj në moshë sepse gjithnjë i respektonte ato.

Esat Bushati nuk ka pasë mundësinë të dilte jashtë vendit për të luajtur ndeshje ndërkombëtare për shkak të biografitë së keqe dhe luftës së klasave megjithatë mbeti një futbollist i nderuar nga të gjithë. Ka luajtur me Vllazninë deri në vitin 1960 teksa sërish ka luajtur si mbrojtës i djathtë. Mbetet një emer i respektuar i historise se futbollit shkodran.

Ceremonia e përcjelljes për në banesën e fundit do të zhvillohet ditën e premte. I përjetshëm qoftë kujtimi yt Esat Bushati.

Lajmit i ka bërë jehonë dhe Benet Beci.

Më poshtë postimi i plotë i tij.

Futbolli shkodran humbi sot një nga emrat e tij të respektuar, Esat Bushatin, ish-futbollistin e Vllaznisë, Partizanit dhe Kombëtares shqiptare.

Një jetë e lidhur me futbollin dhe me fanellën kuqeblu, të cilën e veshi që prej vitit 1947. Shkodra i ka të shtrenjtë njerëzit që kanë shkruar historinë e sportit të saj dhe Esat Bushati do të mbetet një prej tyre.

Ngushëllimet më të sinqerta familjes Bushati, të afërmeve dhe gjithë familjes së madhe të futbollit shkodran.

U prehsh në paqe, Esat!

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Brazil, presidenti Lula i bën apel Ancelottit: Merr më shumë futbollistë që luajnë në kampionatin tonë](#)

13:00 Sport

Presidenti i Federatës Gjermane "i shpall luftë" Infantinos: Është e rëndësishme që sistemi i tij të marrë fund

22:20 Sport / 3 komente

[UEFA Youth League - Partizani shkëlqen në ndeshjen e parë, fiton pastër në transfertë ndaj Valletta-s](#)

22:05 Sport / 2 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.